



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 21 dhe 42 të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Titulli i kontratës: “Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar”

Numri i aktivitetit të prokurimit:

Nr i prokurimit	626-24-5207-1-2-1
Nr i brendshëm	626-24-008-1-2-1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Çmimi për njësi me TVSH i të gjithë artikujve €	Çmimi i poentuar €
1.	MEDPLUS SH.P.K., Rr. Pranvera e Lirisë, 10000, Prishtinë	239.28	2.52
2.	MEDPLUS SH.P.K., Rr. Pranvera e Lirisë, 10000, Prishtinë	552.39	12.33
1.	KONTI SH.P.K., Ali Hadri 27, 20000, Prizren	1,118.99	22.45
2.	KONTI SH.P.K., Ali Hadri 27, 20000, Prizren	1,678.00	103.52
2.	PRO MEDICAL SH.P.K., Rr.Kadri Zeka, 70000, Ferizaj	563.60	27.72

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Mamushës-Zyra e Prokurimit në mbështetje të nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) **Anulon** aktivitetin e prokurimit në fjalë pasi që nuk ka pasur asnjë operator ekonomik të përgjegjshëm.

Data: 12.03.2025

Emri dhe mbiemri i ZPP: Gazmend Gashi

Nënshkrimi:


Këshillë juridike: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i autoritetit kontraktues gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të prokurimit, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës elektronike.

¹Këtij formulari i bashkëngjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46 si dhe vendimi për anulim të tenderit.



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Mamushë më: 12.03.2025

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: Operatorin Ekonomik: MEDPLUS SH.P.K., Rr. Pranvera e Lirisë, 10000, Prishtinë

<i>Nr i prokurimit</i>	<i>626-24-5207-1-2-1</i>
<i>Nr i brendshëm</i>	<i>626-24-008-1-2-1</i>

Titulli: “Furnizimi me material shpenzues per laborator dhe material shpenzues dentar

I nderuar Z. **Jeton Prenaj**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

☒ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;

☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;

☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];

☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;

☐ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;

☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;

☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat formale/administrative

☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale
- ☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.
[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A
- ☐ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.
[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Komisioni i ri-vlerësimit për herë të dytë në bazë të nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurim e ka shqyrtuar përgjigjen e O.E. Duke u bazuar në vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-s me nr. OSHP:2024/1244 të datës 07.02.2025 në arsyetimin e të cilit është kërkuar që AK të bëjë hulumtimin e tregut. Komisioni për rivlerësim të tenderit ka bërë hulumtimin e tregut dhe me këtë rast ka marrë tre oferta të reja nga operatorët ekonomik të përzgjedhur nga platforma elektronike e prokurimit për pozicionet në fjalë për të cilat është kërkuar sqarim si dhe ka shqyrtuar edhe dy oferta të cilat i ka marrë komisioni paraprak me rastin e hulumtimit të tregut. Pas krahasimit të të gjitha këtyre ofertave si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit si dhe pas shqyrtimit të përgjigjes nga O.E. Medplus SH.P.K. të datës 14.11.2024 komisioni për rivlerësim konstaton që ky O.E. ka ofruar tender jo normalisht të ulët sepse O.E. nuk ka ofruar çmime të tregut. Gjithashtu pas shqyrtimit të përgjigjes për çmime jo normalisht të ulëta komisioni unanimisht konstatoi se: Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. nuk i ka ofruar dëshmitë e kërkuara në shkresë të datës 12.11.2024 si dhe nuk ka ofruar sqarim bindës dhe të bazuar në prova. Komisioni vlerësues me rastin e rivlerësimit të tenderit në fjalë analizoi veçanërisht artikujt me nr. 28 dhe 47. Sipas analizës, Komisioni gjatë hulumtimit të tregut gjeti se artikulli me nr. 28 Oxygen Concentrator 5 L në tregun e lirë për ta blerë nga prodhuesi kushton 380.00 €. Transporti i kësaj pajisje kushton 20 % e vlerës që na jep 76.00 €. TVSH-ja 8 % që na jep 30.40 €. Leja në agjencionin e barëra 1.5 % e vlerës që na jep 5.70 €. Si dhe shpenzimet tjera 10 % e vlerës që na jep 38.00 €. Duke i mbledhur te gjitha këto na del vlera e pajisjes 530.10 € pa e kalkuluar fitimin e furnizuesit. Ndërsa O.E. Medplus SHPK për këtë artikull kishte ofruar çmimin 1.50 €.

Gjithashtu gjatë hulumtimit të tregut për artikullin me nr. 47 gjeti se furnizimi me shpatulla druri nga prodhuesi kushton 0.50 €. Transporti 20% i vlerës që na jep 0.10 €. TVSH- 18% e vlerës që na jep 0.09 €. Shpenzimet tjera 10% e vlerës që na jep 0.05 €. Duke i mbledhur te gjitha na del vlera e artikullit 0.74 pa e kalkuluar fitimin e furnizuesit. Ndërsa O.E. Medplus SHPK për këtë artikull kishte ofruar çmimin 0.13 €.

Ndërsa artikujt tjerë i krahasoi me ofertat të cilat i ka marrë me rastin e hulumtimit të tregut, duke e gjetur mesataren e te gjitha ofertave nga te cilat u konstatua qe O.E. ne disa artikuj (7, 19, 28 dhe 47) ka ofruar çmim jo normalisht te ulet ndërsa ne artikujt (14, 15, 18 dhe 23) ka ofruar çmim tepër të lartë në krahasim çmimet e tregut.

Gjithashtu Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. në bazë të vendimit të OSHP-s PSH nr. 156/24 të datës 24.10.2024 është diskualifikuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik nga data 24.10.2024 deri 23.04.2025. Andaj duke u bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me rregulloren nr. 002/2024 neni 37 për ndryshimin e nenit 67 si dhe nenit 63 për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 102 në të cilën shprehimisht është përcaktuar që: Citat “67.9 Në rast se OSHP nxjerr një vendim për diskualifikim të një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në

prokurimin publik prej datës së vendimit. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, “Pjesëmarrja në prokurim publik” është një proces që përfshin tërë ciklin nga njoftimi, aplikimi, përfshirë edhe çfarëdo kundërshtimi apo ankese, deri te vendimi për dhënie të kontratës, rrjedhimisht pamundëson çfarëdo veprimi që Operatori Ekonomik mund të ndërmerr përgjatë tërë procesit të prokurimit prej fazës së publikimit të njoftimit për kontratë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, përfshirë edhe parashtrimin e ankesave. Ky përjashtim vlen për të gjitha llojet e kontratave dhe për të gjitha procedurat e prokurimit. Fund i citatit. Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ju jeni përjashtuar edhe nga kjo procedurë e prokurimit.

Bashkangjitur me këtë letër standarde gjeni vendimin e OSHP-s PSH nr. 156/24 të datës 24.10.2024

Lëshimet e cekura më lart kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,


Gazmend Gashi
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Mamushë më: 12.03.2025

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: Operatorin Ekonomik: “KONTI SH.P.K, Ali Hadri 27, 20000, Prizren”

Nr i prokurimit	626-24-5207-1-2-1
Nr i brendshëm	626-24-008-1-2-1

Titulli: “Furnizimi me material shpenzues per laborator dhe material shpenzues dentar”

I nderuar Z. Gazmend Bojaxhiu

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- ☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara te cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- ☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme te kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;
- ☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];
- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat fomale/administrative

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale

☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A

☐ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Autoriteti Kontraktues me datën 05.11.2024 ka dorëzuar shkresën Letër standarde për sqarimin e tenderit me të cilën është kërkuar sqarim për disa pozicione, por ju nuk jeni përgjigjur deri me datën e kërkuar e cila ka qenë me 07.11.2024 ora 14:00 edhe përkundër që ju kemi paralajmëruar që pa përgjigje në lidhje me sqarimet e kërkuara tenderi juaj do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Lëshimet e cekura më lart kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,


Gazmend Gashi

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Mamushë më: 12.03.2025

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për:Operatorin Ekonomik:“ PRO MEDICAL SH.P.K., Rr.Kadri Zeka, 70000, Ferizaj

<i>Nr i prokurimit</i>	626-24-5207-1-2-1
<i>Nr i brendshëm</i>	626-24-008-1-2-1

Titulli: “Furnizimi me material shpenzues per laborator dhe material shpenzues dentar”

I nderuar Z. Adnan Bala

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- ☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara te cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- ☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme te kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;
- ☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përkshuar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];
- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat fomale/administrative
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale

☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A

☐ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në dosje të tenderit ne nenin 3.1 të Specifikacionet teknike të detyrueshme kemi kërkuar që:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për furnizimet (materialet) e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (Të plotësohet, nënshkruhet dhe vulozet aneksi nr. 7 i kësaj dosje të tenderit).

Pastaj është konstatuar nga komisioni vlerësues se ju nuk keni dorëzuar Deklaratën për specifikacionet teknike, të domosdoshme për furnizimet (materialet) e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit kemi kërkuar që (Të plotësohet, nënshkruhet dhe vulozet aneksi nr. 7 por ju nuk e keni dorëzuar kërkesën e lartë cekur dhe si pasoj tenderi i juaj është refuzuar.

Gjithashtu nga AK me datë 28.08.2024 duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores për Prokurimin Publik, është bërë kërkesa që të zgjasni afatin e ofertës dhe sigurimit të tenderit me të cilën është kërkuar që përmes një deklarate të deklaroni se pajtohen me vazhdimin e validitetit të ofertës si dhe të zgjasni vlefshmërinë e sigurimit dhe të ngarkojnë dëshmitë më së largu deri me datën 30.08.2024 ora 14:00. Ndërsa ju nuk keni bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit sikur është kërkuar nga ana jonë.

Lëshimet e cekura më lart kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Gazmend Gashi

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamuša



Referenca: 626-24-5207-1-2-1

Me 12.03.2025

M a m u s h ë

Në bazë të Nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik neni 43 Paragrafi 43.5 pika (b) si udhëheqës i sektorit të Prokurimit bie këtë:

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-24-5207-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-008-1-2-1

II

Tenderi të rishpallet pas afatit ligjor për parashtrimin e ankesave eventuale.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 31.05.2024 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: "Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar" me nr. të prokurimit 626-24-5207-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-008-1-2-1. Pas njoftimit për kontratë, dosjen e tenderit e kanë shkarkuar nëntëmbëdhjetë (19) Operator Ekonomik, ndërsa tenderin e kanë dorëzuar vetëm tre (3) prej tyre. Fillimisht Në mesin e tenderuesve dy (2) operator ekonomik kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm, ndërsa një (1) prej tyre ka dorëzua tender të pa përgjegjshëm. Pas vendimit të parë dhe të dytë për anulim të kësaj procedure, operatori ekonomik Medplus SHPK ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim. Pas refuzimit të kërkesave i njëjti ka paraqitur ankesë në OSHP. Pasi është shqyrtuar ankesa me vendim të OSHP-s, është kthyer lënda në ri-vlerësim. Gjatë procedurës së rivlerësimit është konstatuar që asnjëri nga O.E. pjesëmarrës nuk ka qenë i përgjegjshëm. Andaj edhe nga komisioni i rivlerësimit është rekomanduar që kjo procedurë e prokurimit të anulohet.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi

Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 156/24

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Batisha Ibrahim - Kryetare, Vedat Poterqoi-Anëtar si dhe Kimete Gashi – Anëtare, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Ministria e Shëndetësisë, me numër 156/24, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE Med Plus Sh.p.k, - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE, me nr: te prokurimit: 206-23-14103-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, më: 24.10.2024, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE Med Plus Sh.p.k, – Prishtinë, me nr. unik 811867441 për periudhën prej gjashtë (6) muajve, nga data: 24.10.2024 deri me 23.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE", me nr: te prokurimit: 206-23-14103-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë.

A R S Y E T I M

Kërkesa e AK- Ministria e Shëndetësisë:

Autoriteti kontraktues pretendon se OE Med Plus&Radix Pharm, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE, me nr: te prokurimit: 206-23-14103-1-1-1, ka mashtruar/falsifikuar ISO standardin me nr: 13485:2016 me arsyetimin se komisioni gjatë vlerësimit ka vërejtur se certifikata ISO me nr: 13485:2016 e lëshuar për

prodhuesin Forlong Medical Co, Ltd China dhe e dorëzuar ne ofertë te OE Med Plus&Radix Pharm, ka validitet deri me 18.10.2024 dhe njëherit komisioni vlerësues ka vërejtur se ne web faqen e prodhuesit Forlong Medical Co Ltd – China e njëjta certifikatë ka validitet tjetër. Certifikata e publikuar ne web faqe ka validitet deri me 18.10.2022.

Me qellim te verifikimit, autoriteti kontraktues, ka kërkuar sqarim me shkrim nga lëshuesi i certifikatës NQA, i cili ne përgjigje ka deklaruar se afati i certifikatës ne fjale ka skaduar me 18.10.2022.

The certificate with No.47014 has expired and been cancelled in October 2022.

Pra, AK-ja mbi bazën e sqarimit te dhëne nga ana autoritetit certifikues NQA, kërkon marrjen e masave sipas nenit 99.2 te LPP-se, sepse sipas AK-se, konzorciumi GOE Med Plus&Radix Pharm e ka modifikuar validitetin e certifikatës ISO 13485:2016.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 21.02.2024 te AK - Ministria e Shëndetësisë, e ka njoftuar konzorciumin GOE Med Plus&Radix Pharm, me qellim qe operatori ekonomik ne fjale te jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-MSH-së.

Përmes përgjigjes se dërguar ne OSHP, OE (Lideri) Med Plus Sh.p.k, fillimisht ka kërkuar nga OSHP-ja, qe nga kërkesa e AK-se për marrjen e masave sipas nenit 99.2 te LPP-se, te përjashtohet OE (anëtari i konzorciumit) Radix Pharm Sh.p.k, sepse sipas liderit Med Plus te gjitha përgjegjësit i barti vet duke e argumentuar se te gjitha komunikimet me prodhuesin Forlong Medical Co, Ltd - China, i kemi zhvilluar ne dhe OE Radix Pharma nuk ka fare dijeni për këtë certifikatë. Pra, sipas OE Med Plus Sh.p.k, certifikatën e prodhuesit Forlong Medical Co, Ltd - China nuk e ka kërkuar OE Radix Pharma, por ne si OE Med Plus Sh.p.k.

Ne vazhdim, OE Med Plus Sh.p.k, ka ofruar deshmit me te cilat e kundërshton ne tërësi dhe njëherit kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, qe kërkesa e AK-se për marrjen e masave te refuzohet, duke e arsyetuar se ne si operator ekonomik kemi shprehur interes për këtë aktivitet te prokurimit andaj, kemi kontaktuar me prodhuesin Forlong Medical Co, Ltd – China, nga i cili i kemi kërkuar deshmit e kërkuara ne dosje te tenderit duke përfshir edhe ISO certifikatën me nr: 13485:2016.

Sipas OE Med Plus te gjitha deshmit duke përfshirë edhe certifikatën ISO te kontestuar, prodhuesi e ka dërguar te ne, përmes email-it dhe njëherit e ka bashkangjitur komunikimin qe OE Med Plus ka pasur me prodhuesin.

MEDPLUS L.L.C KOSOVO <medplusks@gmail.com>
To: Danny Shen <danny.shen@forlongmedical.com>

Tue, Jan 9, 2024 at 12:37 PM

Dear Danny,

Thank you for the authorization.

To attend to this tender CE and ISO are required, can you send CE and ISO13485?

Kind regards,

Jeton Prenaj

MEDPLUS SH.P.K

Wholesaler for Medical Products and Devices

Address: Pristina, Kosovo

Tel.:(whatsapp) +38344640420

[Quoted text hidden]

Danny Shen <danny.shen@forlongmedical.com>
To: "MEDPLUS L.L.C KOSOVO" <medplusks@gmail.com>

Tue, Jan 9, 2024 at 1:03 PM

4 attachments



ISO13485 copy.jpg
2122K

OE Med Plus ne vazhdim te sqarimit te tij, ka deklaruar se pasi e kemi pranuar letrën standarde te tenderuesit te eliminuar përmes te cilës jemi njoftuar se është bere verifikimi i ISO certifikatës dhe se ndryshon data e validitetit te certifikates ISO dhe ne si operatore ekonomik kemi kërkuar sqarim nga prodhuesi Forlong Medical Co, Ltd – China, sepse sipas OE'' Med Plus'' sh.p.k ashtu siç na e ka dërguar Prodhuesi edhe ne e kemi dorëzuar ne ofertën tone ne këtë aktivitet te prokurimit.

OE Med Plus për te argumentuar se nuk e ka modifikuar certifikatën ISO, i ka dorëzuar si dëshmi komunikimet qe ka pasur me prodhuesin Forlan Medical Co Ltd, te cilët kanë shprehur keqardhje për këtë qe ka ndodhur.

MEDPLUS L.L.C KOSOVO <medplusks@gmail.com>
To: Danny Shen <danny.shen@forlongmedical.com>

Tue, Feb 20, 2024 at 11:38 PM

Dear Mr. Danny Shen,

Could you please clarify about your ISO 13485:2016 certificate with number 47014 and validity 18 October 2024 that you sent us in the previous email, because our Ministry of Health after verification has disqualified us from the procurement procedure due to the invalidity of the certificate.

Best regards,
Jeton Prenaj

MEDPLUS SH.P.K

Wholesaler for Medical Products and Devices

Address: Pristina, Kosovo

Tel.:(whatsapp) +38344640420

[Quoted text hidden]

Danny Shen <danny.shen@forlongmedical.com>
To: "MEDPLUS L.L.C KOSOVO" <medplusks@gmail.com>

Wed, Feb 21, 2024 at 3:02 AM

<https://mail.google.com/mail/u/1/?ik=b32647a82a&view=pt&search=all&permthid=thread-a:r-8281439693169664129&simpl=msg-a:r70377622908326...> 6/8

2/02/2024, 09:30

Gmail - Request for offer for products for public procurement

Sorry for this problem

Our QC is applying new ISO13485, let me check with them when it will be ok

OE "Med Plus" sh.p.k përsëri i është drejtuar me shkrim prodhuesit Forlan Medical, duke i kërkuar sqarim se pse e keni ndryshuar datën si prodhues, njëherit duke na dëmtuar dhe se tani Ministria e Shëndetësisë do të na diskualifikoje nga aktivitetet e prokurimit për një vit.

MEDPLUS L.L.C KOSOVO <medplusks@gmail.com>
Draft To: Danny Shen <danny.shen@forlongmedical.com>

Thu, Feb 22, 2024 at 9:28 AM

Dear Danny,

In the minutes of the opening of the tender, we were ranked first with the cheapest price in two groups in the tender of the Ministry of Health, and because you sent us invalid **ISO13485 certificate** with changed data only for **Adhesive Tape 5cm x 5m**, now have we been disqualified from two groups and being investigated for falsification of documents and are at risk of exclusion from participation in public tenders.

Attached is the request of the Ministry of Health to disqualify us from participating in public procurement for one year. We have been damaged a lot by this and the image of the company has also been damaged because we received from you an invalid document with changed data

Can you give us an explanation for this, how it came to send an invalid document with changed data from you as a manufacturer.

Pas kërkesës se prezantuar me lart, OE "Med Plus" sh.p.k nuk ka pranuar sqarim nga prodhuesi Forlan Medical Co.

Ne fund OE Med Plus kërkon që kërkesa e AK-MSH-se, të refuzohet sepse ne nuk e kemi modifikuar certifikatën ISO dhe certifikatën ne fjale ashtu siç na e kanë dërguar edhe kemi dorëzuar ne ofertë.

-Vlerësimi i pretendimeve të autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj Med Plus sh.p.k-

Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin Organi Shqyrtues i Prokurimit pas analizimit të dëshmive të prezantuara, të autoritetit kontraktues dhe OE Med Plus Sh.p.k, dhe deklarimeve të dy palëve vërehet ka ndërhyrje në dëshminë e dorëzuar dhe ky fakt pranohet edhe nga vet operatori ekonomik por që sipas email-it ajo është bërë nga ana e prodhuesit dhe i njëjti nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se këtë ndërhyrje e ka bërë prodhuesi, ashtu siç deklaroi OE “Med Plus” Sh.p.k.

Duke u bazuar në nenin 65 të LPP-se, konkretisht në deklaratën nën betim të dorëzuar, ku thuhet: *“Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-se, respektivisht paragrafin 6 të informacionit për tenderuesin dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit”*

Në rastin konkret OE “Med Plus” Sh.p.k, ka marr përgjegjësin mbi dorëzimin e dëshmive për këtë aktivitet të prokurimit dhe mbi bazën e sqarimeve të dhëna nga vet operatori ekonomik, i cili e konfirmon se ka ndërhyrje në mostrën dhe njëherit nuk qëndron pretendimi se ndërhyrjen e ka bërë prodhuesi sepse siç u sqarua edhe më lartë i njëjti nuk ka dorëzuar prova të mjaftueshme.

Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç parashihet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet, dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, ka dorëzuar prova dhe njëkohësisht OE Med Plus përmes sqarimeve të dhëna është konfirmuar fakti se ka ndërhyrje në dëshminë e dorëzuar dhe ky veprim kualifikohet si mashtrim me të cilin është tentuar të behet autoritetit

kontraktues për aktivitetin e prokurimit: Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE, me nr: te prokurimit: 206-23-14103-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Megjithatë paneli shqyrtues, sqaron se masa e diskualifikimit e shqiptuar dhe e shpjeguar si me sipër mund te revokohet nga momenti kur OSHP, njoftohet nga ndonjë autoritetet kompetent se vepra e cituar me larte nuk është kryer. Po ashtu ne lidhje me diskualifikimin e Operatorit Ekonomik bazuar ne faktet e vërtetuara për falsifikim nga vet autoriteti kontraktues, paneli shqyrtues sqaron se përgjegjësia për faktin e vërtetuar i takon AK-se, edhe nëse eventualisht vërtetohet e kundërta e këtij vendimi nga gjykata kompetente dhe pasojat e kompensimit material mbeten përgjegjësi e AK-se.

Andaj, ne rastin konkret ndaj OE Med Plus Sh.p.k, ka vepruar ne kundërshtim me paragrafin 2 te nenit 99 te LPP-së.

Prandaj, paneli shqyrtues vendosi qe Operatori Ekonomik “ Med Plus” Sh.p.k, të vendoset në listë të zezë për periudhën prej gjashtë (6) muajve, ndërsa OE Radix Pharm Sh.p.k, përjashtohet nga kërkesa e AK-se, për faktin se ne sqarimin e dhënë nga OE ankues i njëjti ka deklaruar se bartës i atij dokumenti/dëshmie është OE “Med Plus” Sh.p.k.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nenin 99.2 te LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Ministria e Shëndetësisë

1x1 OE” Med Plus” Sh.p.k.

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

